VENDIM
Nr.1394, datë 17.10.2008

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SHKOLLËS 9-VJEÇARE, NË QYTETIN E BAJRAM CURRIT, TROPOJË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i shkollës 9-vjeçare në qytetin e Bajram Currit, Tropojë.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Bajram Currit.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 3 945 (tre mijë e nëntëqind e dyzet e pesë) m^2, tokë arë, e vlerësuar me 4 526 (katër mijë e pesëqind e njëzet e gjashtë) lekë/m^2, në shumën e përgjithshme 17 855 070 (shtatëmbëdhjetë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e shtatëdhjetë) lekë.
4. Shpenzimet procedurale, në shumën 193 500 (njëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e pesëqind) lekë, të përballohen nga bashkia e Bajram Currit.
5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit 17 855 070 (shtatëmbëdhjetë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e shtatëdhjetë) lekë, të përballohet nga llogaria speciale, e krijuar si transfertë kapitale për t'u përdorur për shpronësimet.
6. Shpronësimi të fillojë e të përfundojë brenda muajit nëntor 2008.
7. Punimet për ndërtimin e shkollës 9-vjeçare në qytetin e Bajram Currit të fillojnë më 1.6.2009 dhe të përfundojnë brenda datës 31.12.2010.
8. Bashkia e Bajram Currit të bëjë likuidimin e pronarëve brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.
9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe bashkia e Bajram Currit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË SHKOLLËS 9-VJEÇARE BAJRAM CURRI, TROPOJË

Pronari	**Z.K.**	**Nr.pas**	**Sip.are m^2**	**Çmimi arë lekë/m^2**	**Vlera e tokës (lekë)**	**Vlera totale shpronësimi (lekë)**
Rexhep Ibish Gjoçaj	1347	38/1/18	2463	4526	11147538	11147538
Rrustem Avdyl Gjoçaj	1347	38/1/19	1482	4526	6707532	6707532
Shuma			3945		17855070	17855070

Vlera totale e shpronësimit është 17 855 070 (shtatëmbëdhjetë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e shtatëdhjetë) lekë.